

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2740 Prot.
15

Durrës, më 21.11.2025

V E N D I M

Nr. 151, Datë 21.11.2025

PËR

**"RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, NGA
"MENAXHIM I NDËRMARRJEVE TË VOGLA E TË MESME" NË "MENAXHIM
SIPËRMARRJE DHE INOVACION" NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU" Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; në VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; në Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar"; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në relacionin Nr. 2689 prot., datë 19.11.2025 të Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, në mbledhjen e datës 21.11.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e riorganizimit mbi 20% të programit të studimit të ciklit të parë, nga "Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme" në "Menaxhim Sipërmarrje dhe Inovacion" në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, për vitin akademik 2026-2027, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën: **Shqip dhe Anglisht**
3. Kodi i programit të studimit: **63BA 0488 SA**

4. Ky vendim i kalon për miratimin e tarifës përkatëse Bordit të Administrimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

